



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2022:001165

Datë: 11.03.2022

Numri i dokumentit: 02797650

**P.nr.02/22**

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE-DEGA NE VUSHTRRI-Departamenti i përgjithshëm-Divizioni penal**, gjyqtari i vetëm gjykues Ferki Xhaferi, me zyrtaren ligjore Nazmije Maxhera në çështjen penale kundër të pandehurit A. G. nga fshati S. e P. komuna e V., për shkak të veprës penale *Lëndim i lehtë trupor* nga neni 185 par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorit të shtetit PP.II.nr.1803/21 të dt. 21.12.2021, duke vendosur lidhur me kërkesën për dhënien e urdhërit ndëshkimor pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, më datë **18.02.2022**, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

**PRANOHET kërkesa e Prokurorit te shtetit** PP.II.nr.1803/21 të dt. 21.12.2021, andaj gjykata konform dispozitës të nenit 495 të KPPK-së, jep:

### URDHËR NDËSHKIMOR

#### I PANDEHURI

**A. G.** nga i ati V. dhe e ëma F. i lindur ..., me vendbanim ne V., fshati S. e P. me nr.personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

### ËSHTË FAJTORË

**SEPSE:** me datën 03.06.2020, në fshatin S. e P., komuana V. edhe pse ka qenë i aftë që ta kuptoj rëndësinë e veprës së tij dhe të udhëheqë me veprimet e veta, i vetëdijshëm për veprën e tij, ka dashur kryerjen e saj pasi që ka thirrë të dëmtuarin H. G. që të vjen tek ai në shtëpi dhe te ia zbulon se kush ditëve paraprake ka kryer vjedhje në shtëpinë e tij, në një moment fizikisht ka sulmuar të njëjtin duke e goditur me grushte në fytyrë, me ç'rast i dëmtuari ka pësuar lëndime në formë të ndrydhjeve të indeve të buta në kapakun e poshtëm të syrit të majtë - lëndime të karakterizuara si të natyrës së lehtë,

**-Me këtë ka kryer veprën penale: Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par.1.4 të KPRK-së.**

Andaj gjykata-konform dispozitave të neneve 4, 7, 17, 38, 39, 40, 43, 69, 70 dhe nenit 185 par.1 nën par.1.4 të KPRK-ës, si dhe bazuar ne nenet 450,463, 493, 495 të KPPK-së e gjykon me:

### DËNIM ME GJOBË

**Me të cilën të pandehurit A. G.** i caktohet dënimi me gjobë në shumën prej **400€ (katërqind euro)**, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në rast se i akuzuari refuzon të paguajë këtë dënim me gjobë, atëherë ky dënim me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg, duke i caktuar të akzuarit për çdo 20€ (njëzet euro) të dënimit me gjobë, nga 1 (një) ditë burgim.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

**DETYROHET** i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **20(njëzet) euro**, ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën prej **30 (tridhjetë) euro**. Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Mitrovicë ka paraqitur aktakuzën PP.II.nr.1803/21 të dt. 21.12.2021, kundër të pandehurit A. G. nga fshati S. e P., komuna e V. për shkak të veprës penale *Lëndim i lehtë trupor* nga neni 185 par.1 nënpar1.4 të KPRK-së.

Gjykatës i është kërkuar që kundër të pandehurit të jep Urdhërin Ndëshkimor me arsyetimin e besueshëm nga kallzimi penal dhe provat e bashkangjitura lidhur me bazueshmërinë e aktakuzës së prokurorisë se shtetit në drejtim të vërtetimit të fakteve se i pandehuri vërtetë e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Me dispozitat ligjore të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, për veprën penale *Lëndim i lehtë trupor* nga neni 185 par.1 nënpar1.4 të KPRK-së, me të cilën akuzohet i pandehuri, ligjvënësi ka parashikuar dënimin me gjobë ose burgim deri në tre (3) vite, që nënkupton se në rastin konkret zbatohen dispozitat ligjore të procedurës së veçantë nga neni 493 dhe 495 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës. Me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes e konform nenit 493 të KPPK-së, gjyqtari i vetëm gjykues gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 493 të KPPK-së dhe konform dispozitave nga neni 495 par.1 të KPPK-së ashtu që mori vendim që ta pranoj kërkesën për dhënien e urdhërit ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës si: kallzimi penal me nr.2021-BD-465 i datës 30.10.2021, raporti fillestar i incidentit i datës 03.06.2021, procesverbali i marrjes në pyetje për të dëmtuarin i datë 03.06.2021, procesverbali i marrjes në pyetje për të dyshuarin i datë 01.07.2021, raporti i oficerit i datë 03.06.2021, akt ekspertimi mjeko-ligjor i Dr. F. B. i datë 12.12.2021, raporti mjekësor i lëshuar nga spitali "Sh. Z." i datë 03.06.2021 si dhe shkresat e tjera të lëndës janë prova të besueshme me të cilat vërtetohet se në veprimet e të akzuarit ekzistojnë elemente të veprës penale *Lëndim i lehtë trupor* nga neni 185 par.1 nënpar1.4 të KPRK-së, për këtë edhe i shqipton urdhërin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata morri parasysh rrethanat si: shkallën e përgjegjësisë penale, meqë në këtë rast vepra është kryer me dashje nga ana e të pandehurit, si dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, pasi që i pandehuri e kishte thirrur të dëmtuarin në shtëpinë e tij dhe aty edhe e kishte goditur.

Gjykata çmon se dënimi me gjobë i shqiptuar është i drejtë dhe i ligjshëm, dhe se është në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale së të pandehurit dhe me intesitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur. Së këndejmi me praninë e të gjitha këtyre rrethanave nuk ka pasur vend që të pandehurit t'i shqiptohet një dënim më i butë ose me i rëndë.

Andaj gjykata vlerësoi se edhe me këtë dënim të shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit në vështirim me nenin 38 të KPRK-së, që të parandaloj kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tij, që në të ardhmen i pandehuri të ketë të kujdes të shtuar që të mos bie në kundërshtim me ligjin, pasi që gjykata mundet të ashpërsoi dënimin kundër tij, si dhe me këtë dënim shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer dhe ngrit moralin dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale për paushall gjykata e mori në kuptim të nenit 450 par.2 nën paragrafi 2.6 lidhur me par. 1 të KPPK-së, ndërsa vendimin mbi kërkesën pasurore juridike gjykata e mori në bazë të nenit 463 par.2 të KPP-së. Ndërsa vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e morri në bazë të nenit 39 par.3 pika 3.1 të Ligjit nr. 05/L-36 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë në kuptim të nenit 365 të KPPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE-DEGA NE VUSHTRRI**  
**Departamenti i përgjithshëm-Divizioni penal**  
**P.nr.02/22, të datës 18.02.2022**

**Zyrtarja ligjore**  
**Nazmije Maxhera**

**Gjyqtari i vetëm gjykues**  
**Ferki Xhaferi**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtimi në afat prej 8 ditëve nga dita e marrjes me shkrim. Kundërshtimi i drejtohet kësaj gjykate me shkrim apo me gojë në procesverbal të gjykatës.